



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 48

Prishtinë, më 28.02. 2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, kryetar, Ganimete Musliu, nënkryetare e parë, Rexhep Selimi, Anton Quni, Qerim Bajrami, Fatmir Shurdhaj, Nuredin Ibishi dhe Zafir Berisha, anëtarë.

Mungoi: Bojan Mitiq.

Përfaqësuesit nga Inspektoriati Policor i Kosovës- Hilmi Mehmeti- Kryeshef i Inspektoriatit Policor, Mirdajje Kelmendi-Departamenti i Ankesave dhe Bujar Mustafa-Inspektor.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ganimete Zeka-Praktikante dhe Plator Avdiu- QKSS.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 24.01.2017 dhe 13.02.2017;
3. Raportimi i kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës z. Hilmi Mehmeti;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetari konstatoi miratimin e rendit të ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 24.01.2017 dhe 13.02.2017

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbaleve, të mbajtura më 24.01.2017 dhe 13.02.2017, pa ndryshime.

3. Raportimi i kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës, z. Hilmi Mehmeti.

Kryetari theksoi se përveç raportimit vjetor të kryeshefit të IPK-së në këtë takim do të ketë edhe pyetje lidhur me zbatimin e Ligjit për Inspektoratit të Policisë së Kosovës, për të cilën gjë është formuar grupi punues në kuadër të Komisionit. Gjithashtu ngriti çështjen e arrestimeve të fundit të disa zyrtarëve policorë, ndryshimet në organogramin e IPK-së, pezullim i detyrës si zyrtar policor, nga ana kryeshefit të IPK-së. Fjalën ia kaloi kryeshefit të IPK-së dhe më pas deputetët të marrin fjalën.

Hilmi Mehmeti, kryeshef i Inspektoratit Policor të Kosovës, theksoi që Inspektorati Policor i Kosovës, në zbatim të funksioneve ligjore, si dhe objektivave të përcaktuara nga menaxhmenti i IPK-së, edhe gjatë vitit 2016 ka ushtruar veprimtarinë e vet në përgjegjësit që ka. Më tutje prezantoi raportin vjetor të Inspektoratit Policor për vitin 2016.

Sa i përket punës së IPK-së, për vitin 2016, theksoi që për të përmbushur detyrat e saj, IPK-ja ka bashkëpunuar me OSBE, ICITAP, si dhe me institucionet e tjera. Janë mbajtur 24 tryeza të rrumbullakëta me zyrtarë policorë në të gjitha nivelet e organizimit në Policinë Kosovës, takime me qytetarë në kuvendet komunale, ku janë përfshirë edhe katër komunitet veriore (Leposaviq, Veçan(Zveçan), Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok). Gjithashtu shtoi se kanë qenë pjesëmarrës në dy konferenca, njëra në Mal të Zi dhe në Letoni.

Ndërsa sa i përket numrit të ankesave nga ana e qytetarëve, theksoi që për vitin 2016 ka pasur rritje të ankesave, nga 1237 sa ishin në vitin 2015, në vitin 2016 kanë qenë 1362, do të thotë 9.25% rritje. Gjithashtu shtoi se të gjithë qytetarët të cilët kanë bërë ankesa, janë njoftuar me shkrim për statusin e ankesës së tyre. Theksoi që në vitin 2016 ka pasur rritje të numrit të qytetarëve që kanë paraqitur ankesa nga komuniteti serb, dhe sipas tij kjo tregon një rritje të besimit ndaj institucionit.

Ndërsa sa i përket hetimeve, theksoi që nga IPK-ja gjatë vitit 2016 janë 671 raste, ndërsa në vitin 2015 kanë qenë të trajtuara 729 raste, dhe sipas kësaj janë 58 raste më pak. Në vitin 2015 kanë qenë gjithsej 23 zyrtarë policorë të arrestuar, ndërsa në vitin 2016 janë arrestuar 69 zyrtarë policorë. Ndërsa sa i përket hetimeve speciale, në vitin 2015 janë trajtuar 3 raste, ndërsa në vitin 2016 vetëm 12 raste.

Sa i përket inspektimeve, departamenti i inspektimeve gjatë vitit 2016 ka zhvilluar 9 inspektime, 5 të rregullta dhe 4 të jashtëzakonshme, nga të cilat kanë dalë gjashtëdhjetë rekomandime për Policinë e Kosovës. Ndërsa sa i përket rekomandimeve theksoi që përcillen te drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Rekomandimet kanë qenë të natyrës: largim nga detyra, suspendim, transferim. Janë zhvilluar edhe dy inspektime të përbashkëta me autoritete e Republikës së Shqipërisë, në policinë kufitare dhe komunikacionin rrugor.

Ndërsa duke iu referuar departamentit të administratës dhe shërbimeve mbështetëse, theksoi se kanë përmbushur të gjitha detyrat e përcaktuara. Sa i përket realizimit të buxhetit, prej buxhetit një milion e njëqind mijë euro, është realizuar me 99.68%. Më tutje theksoi që sfidauese ka qenë zbatimi i vendimeve të gjykatave, me shumë prej pesëdhjetë mijë euro për dy zyrtarë të IPK-së, mjete të cilat nuk kanë qenë të planifikuara, por është dashur të bëhen shkurtime. Edhe në vitin 2017 dhe kompensimi për dy zyrtarë në shumën prej gjashtëdhjetë mijë euro.

Sa i përket auditorit të brendshëm, theksoi se ka realizuar katër auditive të rregullta, dhe ku është dalë me tridhjetë e një rekomandime, ku njëzet e gjashtë janë zbatuar, pesë janë në proces të zbatimit.

Më tutje theksoi që për vitin 2016, është pranuar donacioni në pajisje nga ICITAP, dhe është ofruar trajnimi profesional që do të realizohet në muajin mars të këtij viti, ndërsa është përgatitur një program i trajnimeve të brendshme për zyrtarët e IPK-së.

Më tutje paraqiti dy kërkesa për të cilat kërkon mbështetjen e Komisionit; lëvizjen e objektit të IPK-së, nga Hajvalia në Prishtinë dhe mbështetje në rekrutimin e njëzet e tre punonjësve të rinj, për të cilët është aprovuar kërkesa në ligjin për buxhet, pra duhet pasqyrimi i mjeteve buxhetore.

Zafir Berisha, duke iu referuar rasteve për të cilat është dashur të zbatohet vendim i gjykatës, theksoi që është fenomen në shumë institucione. Tutje shtroi pyetjet: Personat që kanë bërë shkelje dhe që veprimet e tyre kanë kosto buxhetore, a hetohen dhe a merren masa ndaj tyre? A duhet të rekomandon IPK-ja që duhet të ketë rekomandime shtesë, për shkak të rritjes së numrit të shkelësve nga radhët e policisë?

Hilmi Mehmeti, kryeshf i Inspektoratit Policor të Kosovës, në përgjigjeje të pyetjeve të z. Berisha, theksoi që edhe mos zbatim i vendimeve të gjykatës të formës së prerë është vepër penale, ndërsa për rastet konkrete në IPK, personat përgjegjës janë në procedurë gjyqësore dhe janë duke u hetuar. Ndërsa sa i përket inspektimeve, theksoi që aktualisht janë duke e bërë një të tillë në komunikacionin rrugor, ku do të dillet me rekomandime.

Rexhep Selimi ngriti dy çështje: Sa i përket rritjes së numrit të ankesave të qytetarëve serbë, çfarë domethënie kjo dhe pse duhet të evidentohet? A planifikoni të riktheheni në policinë e Kosovës, pas përfundimit të mandatit si kryeshf i IPK-së? A vlerësoni që është konflikt interesi dhe pse nuk jepni dorëheqje?

Hilmi Mehmeti, kryeshef i Inspektoratit Policor të Kosovës, në përgjigjeje të pyetjes së z. Selimi, theksoi që është hera e parë në vitin 2016 ku janë organizuar tryeza edhe në pjesën veriore, dhe kjo ka kontribuar në ndërgjegjësimin për paraqitjen e ankesave. Ndërsa në përgjigjeje të pyetjes së dytë, theksoi që nuk planifikohet të kthehet, ndërsa theksoi se për çështjen e pezullimit ka dhënë sqarim Agjencia Antikorrupsion.

Nuredin Ibishi shtroi pyetjet si vijon: Cilat janë masat preventive të ndërmarra nga IPK-ja, për të shmangur shkeljet nga zyrtarët policorë në të gjitha nivelet, a duhet bërë edhe testi integritetit? Përse në rastet më të shumta për të cilët ngritët dyshimi, janë zyrtarë policorë të nivelit më të ulët në grada, ku është nivel i mesëm, niveli i lartë menaxherial? A do ndërmerren masa që mos të përsëriten raste që rastet në suspendim të mos vazhdojnë të jenë të tilla dhe mos të zbatohen vendimet e gjykatave?

Hilmi Mehmeti, kryeshef i Inspektoratit Policor të Kosovës, në përgjigjeje të pyetjes së z. Ibishi, theksoi që masat e ndërmarra janë rekomandimet, inspektimet në fushat përkatëse, kontaktet e drejtpërdrejta me menaxhmentin dhe me zyrtarët policorë dhe sensibilizimi i qytetarëve. Në përgjigjeje të pyetjes së dytë, theksoi që për të gjitha rastet që posedojnë informacione ndërmarrin masa, por pas rastit të fundit janë bërë ehe ndryshime në nivel menaxhrial, pasi është konsideruar që edhe ata bartin përgjegjësi. Ndërsa në përgjigjeje të pyetjes së tretë, theksoi që në IPK zyrtarët e suspenduar marrin njëqind për qind pagën dhe nuk ka kufizim gjashtëmuor, kjo është parë si e metë dhe udhëzimi administrativ do të ndryshohet në tremujorin e vitit 2017.

Kryetari shtroi pyetjen si vijon; Si është marrë vendimi për suspendimin dy drejtorëve të IPK-së, z. Abdullah Aliu dhe Albana Osmani?

Anton Quni, duke iu referuar statistikave të paraqitura në raportin vjetor, shtroi pyetjet: A është bërë ndonjë studim, ose a mendon se duhet bërë, për kualitetin e punës në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike? Kjo për të identifikuar shkelësit në institucione të ndryshme ndër gjenerata.

Hilmi Mehmeti, kryeshef i Inspektoratit Policor të Kosovës, theksoi që nuk posedojnë një studim të tillë, por theksoi që është duke u punuar në planprogramin për kadetët e ardhshëm në Policinë e Kosovës. Ndërsa sa i përket një hulumtimi të tillë theksoi se duhet shikuar a lejon baza ligjore për një gjë të tillë.

Bujar Mustafa-Inspektor, theksoi që është pjesë e procesit të bërjes së kurrikulave për institucionet e sigurisë së Kosovës, në bashkëpunim me shtetin Finlandez dhe të Estonisë theksoi që në bashkëpunim me ministrin e Arsimit është tentuar krijim i standardeve të profesionit për zyrtarët policorë dhe për inspektor. Më tutje theksoi që standardet dhe kurrikulat janë bërë dhe për këtë kanë pasur vlerësim maksimal nga ekspertët.

Fatmir Shurdhaj, shtroi pyetjet si vijon; Sa bashkëpunon Inspektorati Policor i Kosovës me rajonin? Sa i përket çështjes së gradimeve, a ka diskriminim pozitiv për komunitete? A ka pasur raste, që pas marrëveshjes së Brukselit, personat e përfshirë në policinë e Kosovës, kanë qenë të dyshimtë të përfshirë në trazira në veri të Kosovë? Sa është përgatitur Inspektorati Policor i Kosovës, në bazë të detyrave që ka për departamentet që ka?

Hilmi Mehmeti, kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës, në përgjigjeje të pyetjeve të z. Shurdhaj, theksoi se bashkëpunim ka me Republikën e Shqipërisë me institucionin homolog dhe gjatë vitit 2016 janë bërë dy inspektime të përbashkëta, draft marrëveshjet e bashkëpunimit janë të përgatitura edhe me Malin e Zi dhe Maqedoninë dhe janë në procedurë. Ndërsa sa i përket marrëveshjes së Brukselit, theksoi se nuk do të komentojë, ndërsa sa i përket përgatitjes profesionale, theksoi se të gjithë zyrtarët janë të përgatitur për përgjegjësitë që kanë.

Ganimete Musliu theksoi se dëshiron të dijë lidhur me propozimin për ndryshimin e rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor. Në bazë të cilës analizë është ndërmarrë një veprim i tillë apo plan fisibiliteti, nëse jo, pse nuk është bërë një plan i tillë? Sa i përket emërtimit të pozitës së udhëheqësit të Inspektoratit, a ka pësuar ndryshim? Ndërsa sa i përket projektligjit për nivelizimin e pagave, a është përmirësuar pjesa, ku të gjithë pjesëtarët e IPK-së janë cilësuar si shërbyes civilë?

Hilmi Mehmeti, kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës theksoi se analiza e tillë është bërë dhe Komisioni prej shtatë anëtarëve dhe është dalë në konkluzionin që udhëzimet kanë nevojë për ndryshim. Më tutje theksoi se udhëzimet administrative kanë kaluar të gjitha procedurat ligjore dhe është finalizuar me nënshkrimin e ministrit të Punëve të Brendshme. Ndërsa sa i përket emërtimit, theksoi se në Ministrinë e Administratës Publike është ndryshuar emërtimi i pozitës së kryeshefit, por theksoi se në takimet e radhës që do të jenë tentohet të ndryshohet kjo situatë. Pasi sipas informacioneve që posedon, është bërë lëshim pasi është keqkuptuar termi inspektor.

Qerim Bajrami shtroi pyetjet si vijon: A ka evidenca Inspektorati Policor i Kosovës për komunitetet e tjera që kanë bërë ankesa, përderisa është identifikuar numri i ankesave nga komuniteti serb? A do të ketë rritje të numrit të punësuarave, e preferueshme nga komuniteti boshnjak, për ngritjen e kapaciteteve, pasi mund të ketë ankues të komuniteti boshnjak? Pasi janë vizituar komunat në veri të vendit, a është vizituar fshatin Rvacka në Leposaviq, ku jetojnë pjesëtarë të komunitetit boshnjak?

Hilmi Mehmeti, kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës, theksoi se janë të paraqitura në raportin vjetor. Ndërsa sa i përket numrit të të punësuarve, theksi se në kërkesën për të punësuar njëzet e tre zyrtarë do të ketë edhe të komuniteteve të tjera. Po ashtu theksoi se janë takuar edhe me pjesëtarë të komuniteteve të tjera, përveç atij serb në pjesën veriore.

Kryetar shtroi pyetjen si vijon; Çfarë nënkupton hetimi i katërmbëdhjetë zyrtarëve të stafit civil? Sa inspektorë janë nën hetime dhe kur është dhënë informacioni i fundit nga prokuroria? Mos është duke u ndërhyrë politikisht ndaj zyrtarëve të IPK-s? Sa bashkëpunoni me Njësinë e Standardeve Profesionale në kuadër të Policisë së Kosovës, dhe cili është niveli i bashkëpunimit?

Hilmi Mehmeti, kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës, në përgjigjeje të pyetjeve të z. Haradinaj, theksoi se ata zyrtarë janë staf civil që punonin në kuadër të Policisë së Kosovës. Ndërsa janë dy inspektorë nën hetime dhe janë në masën e suspendimit, duke shtuar që për këta dy inspektorë është marrë masa e suspendimit në bazë të vendimit të prokurorisë. Ndërsa sa i përket ndikimit politik, theksoi që asgjë nuk është ndërmarrë në baza politike, por është vepruar

me racionalizëm. Ndërsa sa i përket asaj se janë transferuar zyrtarë policorë, theksoi se kjo është çështje e policisë dhe jo e IPK-së dhe bashkëpunimi me njësinë e standardeve është shumë i mirë.

Kryetari falënderoi për raportimin vjetor dhe për përgjigjet në pyetjet lidhur me zbatimin e Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës, duke shtuar që nga ana e IPK-së duhet të jetë një qasje më efektive, në mënyrë që rastet e mbyllura ose që janë të hapura nga prokuroria të procedohen sa më shpejt, në mënyrë që të mos ketë zvarritje në marrjen e vendimeve dhe që ndikon në efikasitetin dhe shpenzimin e buxhetit.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive.

Rexhep Selimi, në cilësinë kryesuesit të grupit punues, paraqiti raportin me amendamente për Projektligjin nr.05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive. Më tutje theksoi se janë përgatitur shtatëmbëdhjetë amendamente, ku shumica janë të natyrës teknike, ndërsa thelbësor e konsideroi ndryshimin e emrit të projektligjit që do të jetë “*Ligjin nr.05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve , municionit dhe mjeteve eksplozive*” Ndërsa në amendamentin 2 do të ketë një ndryshim të natyrës teknike, e cila është më e arsyeshme të bëhet.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet raporti me amendamente për Projektligjin nr.05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive dhe i rekomandohet Kuvendit miratimin e tij.

5. Të ndryshme.

Nuredin Ibishi i njoftoi se pasi ka proceduar një rast në Inspektoratin Policor të Kosovës, është konstatuar që nuk ka pasur vepër penale por vetëm shkelje disiplinore, për komandantin e trafikut rajonal në Pejë, Arben Zoiqi, dhe është ndërmarr masa disiplinore shkelje e rëndë dhe është dënuar me heqje të 30 % të pagës për dy muaj.

Kryetari propozoi që çështja e respektimit të kodit të etikës, mund të adresohet te drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Rexhep Selimi propozoi që edhe në raportin përfundimtar për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të IPK-së, të jete rekomandimi sa i përket çështjes së përdorimit të rrjeteve sociale nga zyrtarët policor.

Fatmir Shurdhaj ngriti çështjen e inkuadrimin në Policinë e Kosovës të personave që kanë qenë në struktura kriminale. Qeveria e Kosovës, në mandatin e kaluar e ka amnistuar krimin në veri dhe njerëz me krime të rënda nuk kanë të drejtë të rekrutohen, pa marrë parasysh a e mundëson marrëveshja e Brukselit, apo jo.

Kryetari, lidhur me çështjen e ngritur nga z. Shurdhaj, theksoi se ka pasur listën e 147 serbëve të cilët në pako janë regjistruar në emergjencat e Kosovës.

Qerim Bajrami propozoi që gjatë muajit mars të realizohet një vizitë në fshatin Restelicë, si dhe të vizitohet stacioni rajonal në Prizren.

Kryetari me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj